



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet:

KOMUNËS SË GJAKOVËS

dhe

GRUPIT PËR STUDIME JURIDIKE DHE POLITIKE (GLPS)

për implementimin e projektit të titulluar:

“LEARNING BY DOING: boosting local civic activism by transferring the ‘know-how’ at local CSOs on how to deploy Social Audit in Kosovo” (shqip: “TË MËSOSH DUKE PRAKTIKUAR: rritja e aktivizmit qytetar lokal duke transferuar njohuritë të OSHC-të lokale se si të vendoset Auditimi Social në Kosovë”)

mbështetur nga: USAID Komuna Transparente, Efikase dhe Llogaridhënëse

19 korrik 2021



Neni 1 [Fushëveprimi]

Ky Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe GLPS-së lidhet me qëllim të mundësimit të zbatimit të projektit të titulluar: "LEARNING BY DOING: boosting local civic activism by transferring the 'know-how' at local CSOs on how to deploy Social Audit in Kosovo" ("TË MËSOSH DUKE PRAKTIKUAR: rritja e aktivizmit qytetar lokal duke transferuar njohuritë te Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) lokale se si të vendoset Auditimi Social në Kosovë") financuar nga: USAID Komuna Transparente, Efikase dhe Llogaridhëse dhe zbatuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) me numër të regjistrimit 5110959-7. Qëllimi i këtij Memorandumi është që të përcaktoj veprimet e përbashkëta ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe GLPS-së sa i përket zbatimit të këtij projekti.

Neni 2 [Qëllimi i Memorandumit]

Qëllimi i këtij Memorandumi është të përcaktoj përgjegjësitë e secilës palë, me synim të bashkëpunimit si dhe dhënies së qasjes së plotë në të dhëna publike, të nevojshme për zbatimin e projektit.

Neni 3 [Përgjegjësitë e Komunës së Gjakovës]

Komuna e Gjakovës do të marr përsipër që, bazuar në përgjegjësitë që ka, t'i jap qasje të plotë Grupit për Studime Juridike dhe Politike në të dhëna dhe dokumente publike të nevojshme për zbatimin e projektit në fjalë, atëherë kur kërkohen nga stafi zyrtar i projektit. Komuna e Gjakovës merr përsipër që t'i njoftoj të gjitha strukturat (drejtoritë dhe departamentet) e saj në lidhje me këtë memorandum, dhe t'u kërkoj atyre që të ofrojnë të dhëna publike, në rast nevojë.

Neni 4 [Përgjegjësitë e GLPS-së]

Grupi për Studime Juridike dhe Politike merr përsipër që të menaxhoj në tërësi me projektin në fjalë dhe që të dhënat dhe dokumentet e marra nga Komuna e Gjakovës të përdoren vetëm për qëllim të implementimit të këtij projekti, më konkretisht, për qëllime hulumtimi dhe monitorimi. Grupi për Studime Juridike dhe Politike nuk mund të shfrytëzoj këtë Memorandum Bashkëpunimi për asgjë tjetër, pos për zbatimin e projektit në fjalë.

Neni 5 [Bashkëfinancimi]

1. Me qëllimin e vendosjes së qëndrueshmërisë së projektit që në të ardhmen e afërt, Komuna e Gjakovës zotohet që të bashkëfinancojë projektin në shumën prej 2,000.00 EUR, shumë kjo që do të i ndahet një organizate joqeveritare në Komunën e Gjakovës.
2. Komuna është përgjegjëse për mbikëqyrjen e shumës së lartëcekur të bashkëfinancimit, pra organizata joqeveritare do të i raportojë Komunës.



Neni 6 [Parimet që qeverisin këtë Memorandum]

Palët pajtohen që në zbatimin e këtij Memorandumi të ndjekin parimet e transparencës së plotë, integritetit dhe angazhimit në mirëbesim ndërmjet tyre.

Neni 7 [Raportimi për zbatimin e Memorandumit]

Palët pajtohen që raportimi për zbatimin e këtij Memorandumi bëhet mes Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe Komunës së Gjakovës.

Neni 8 [Zgjidhja e Memorandumit]

Palët mund të zgjidhin këtë Memorandum në rastet kur ekzistojnë kushtet objektive që e arsyetojnë një gjë të tillë.

Neni 9 [Kohëzgjatja]

Ky Memorandum zgjat deri në përfundim të projektit, që është objekt i këtij Memorandumi.

Neni 10 [Nënshkrimi i Memorandumit]

Ky Memorandum nënshkruhet nga Palët dhe fillon së zbatuari nga dita e nënshkrimit të tij. Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të plotësohet apo ndryshohet me marrëveshje me shkrim nga të dy palët. Ky Memorandum nënshkruhet në dy kopje të njëjta, nga një kopje për gjithsecilën palë.

Palët Nënshkruese


Për Komunën e Gjakovës:



A blue ink signature of Ardian Gjini is written over a circular official stamp of the Municipality of Gjakova, Republic of Kosovo.

z. Ardian Gjini
Kryetar
(vula)

Për GLPS:



A blue ink signature of Njomza Arifi is written over a horizontal line.

znj. Njomza Arifi
Menaxhere e Programit
(vula)

